

Strategjia e BE-së për zgjerim për Ballkanin Perëndimor – Kosova në pritje

Viti 2018 do të sjell një agjendë të re për Ballkanin Perëndimor. Bashkimi Evropian planifikon të ndër marr tre aktivitete të rëndësishme në raport me Ballkanin Perëndimor; me një perspektivë dhe përmbajtje plotësisht të re. *Një Perspektivë e Besueshme e Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor* parashikon që Serbia, Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnje e Hercegovina dhe Kosova të lëvizin drejt anëtarësimit të plotë në BE, brenda një kornize sa më të përshtatshme kohore. Megjithatë, disa prej tyre do të lëvizin më shpejtë se të tjerat.

Në gjysmën e parë të vitit, BE-ja parashikon disa aktivitete në raport me Ballkanin Perëndimor;

- Në shkurt, BE-ja do të publikojë Perspektivën e Besueshme të Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor
- Në prill, BE-ja do t'i publikojë raportet gjithëpërfshirëse shtetërore për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor
- Në maj, në Sofje të Bullgarisë, do të mbahet Samiti BE-Ballkani Perëndimor

Në vitin 2014, Procesi i Berlinit, një iniciativë kjo e udhëhequr nga Gjermania me qëllim të nxitjes së lidhjes dhe komunikimit në Ballkan, kryesisht u pa si një zëvendësim i dobët i procesit të integritimit në Bahskimin Evropian për Ballkanin Perëndimor. Tani, me publikimin e Strategjisë së Zgjerimit të BE-së, kjo frikë do të zvogëlohet së paku pjesërisht.

Është paraparë që këto tri ngjarje të promovojnë dhe të trasojnë rrugën e anëtarësimit për gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6) në Bashkimin Evropian. Pas skepticizmit shumëvjeçar ndaj zgjerimit, Komisioni i BE-së papritmas ndryshoi kursin. Insitucionet e Brukselit tani e dëshirojnë Ballkanin Perëndimor brenda BE-së. Po ashtu, përgatitja do të shtrihet edhe brenda planifikimit të buxhetit të BE-së për periudhën 2019-2025, i cili do të përfshijë më tepër programe zgjerimi dhe asistencë financiare për shtetet që aplikojnë.

Të preferuarit

Draft strategjia i cilëson shtetet e Ballkanit Perëndimor si partner, *“Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës, që edhe gjeografikisht është i rrethuar me shtetet anëtare të BE-së. Banorët e BE-së dhe të rajonit kanë një trashëgimi të përbashkët, një histori dhe të ardhme të definuar nga mundësitë dhe sfidat e përbashkëta”*. Pavarësisht trashëgimisë dhe sfidave të përbashkëta, dokumenti përcakton një kornizë të qartë vetëm për dy shtete kandidate, duke nënvizuar se Mali i Zi dhe Serbia mund të jenë të gatshme për anëtarësim deri në vitin 2025.

Dokumenti propozon që katër shtetet e tjera, Shqipëria, Bosnje e Hercegovina, Maqedonia dhe Kosova, deri atëherë të avancojnë ndjeshëm në rrugën e tyre drejt Evropës. Strategjia i përcakton kandidatët prijës, *“me kusht që të gjitha standardet të jenë përmbushur, ajo ofron përmbylljen e të gjitha negociatave me Malin e Zi dhe Serbinë, deri në vitin 2023”*. Thënë praktikisht, të dy këto shtete, e Mali i Zi në veçanti, kanë shënuar një përparim të ndjeshëm në kapitujt e negociuar. Mirëpo, vendosja e të preferuarëve është në kundërshtim me deklaratën e Komisionerit për Fqinjësi të Mirë dhe Zgjerim (DGE Near), Johannes Hahn, i cili bën thirrje për një zgjerim ‘në bllok’. Ai mund edhe të mos ketë menduar për të gjashtë shtetet, por të paktën në katër prej tyre, Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Malazezët janë të mllefosur me synimin për të i 'paketuar' ata së bashku me Serbinë, e cila është disa hapa prapa dhe të cilës ende i duhet zgjidhur çështjet më të vështira bilaterale. Një diplomat evropian komentoi se "Junker është i obsesionuar me Rusinë, andaj edhe e dëshiron Serbinë brenda me çdo kusht". Gjermania dhe Austria e kundërshtojnë përcaktimin e të preferuarve. Zyrtarët në Berlin presin që Maqedonia dhe Shqipëria të shënojnë një përparim më të madh dhe ta arrijnë Serbinë.

Reformat

Raportet e progresit për shtetet e Ballkanit, do t'i definojnë detyrat, prioritetet dhe reformat që duhet t'i ndërmarrë secili shtet, në mënyrë që të përparojë drejt anëtarësimit.

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, gjatë adresimit të tij vjetor të vitit 2017, nënvizoi se: *"Nëse dëshirojmë më shumë stabilitet në fqinjësinë tonë, atëherë ne po ashtu duhet të mirëmbajmë një perspektivë të besueshme të zgjerimit për Ballkanin Perëndimor. Është e qartë se nuk do të ketë zgjerim të mëtutjeshëm gjatë mandatit të këtij komisioni, e as të këtij Parlamenti. Asnjëri shtet kandidat nuk është i gatshëm. Mirëpo, pas kësaj periudhe Bashkimi Evropian do të jetë më i madh me numër sesa 27. Gjatë negociatave, kandidatët për anëtarësim duhet t'i kushtojnë prioritet maksimal sundimit të ligjit, drejtësisë dhe të drejtave fundamentale"*.

Junker i nënvizoi vetëm tri fusha të përmirësimit; ndërkaq strategjia e re i shton edhe konkurueshmërinë, bashkëpunimin rajonal dhe pajtimin, si "fusha vendimtare" për "reforma bindëse". Pritet që Shqipëria dhe Maqedonia t'i fillojnë negociatat shumë shpejt; e para *"duhet të arrijë një implementim bindës në pesë fushat prioritare, përfshirë këtu reformat aktuale në gjyqësor"*. Maqedonia ndërkaq duhet të arrijë rezultate të prekshme të reformave dhe të zgjidhë "çështjen e emrit" me Greqinë. Dokumenti është i paqartë për sa i përket prioritetëve dhe kornizës kohore për shtet tjera. Strategjia ofron hapjen e negociatave për anëtarësim për Bosnje e Hercegovinën tek në vitin 2023.

Përderisa strategjia tingëllon si një plan premtues për sa i përket hyrjes eventuale në BE, proceset e aderimit janë të paqartësuara ngase ka shumë përjashtime, të cilat mund ta vonojnë procesin. Strategjia bën thirrje për reforma që do të transformojnë shoqëritë e Ballkanit, bashkë me liderët dhe qytetarët, përmes supozimeve dhe ofrimit të "aspiratave evropiane". Disa qeveri mund të mos i bëjnë ato, por gjithsesi do t'iu duhet të tregojnë shpejt nëse kanë vullnet për ndërrim të kursit.

Ku është Kosova në këtë strategji?

Strategjia i referohet Kosovës vetëm në kontekstin e dialogut me Serbinë, si një pikëreferim për pranimin e Serbisë. Një zyrtar evropian vuri në dukje se, "Duket që rruga e Kosovës drejt BE-së kalon nëpërmjet Beogradit". Strategjia nuk ofron asnjë përkufizim lidhur me statusin e një shteti kandidat për anëtarësim.

Strategjia vë në dukje se, deri në fund të vitit 2019, Serbia duhet t'i mbyllë standartet e përkohshme që ndërliken me Kapitullin 35. Ajo bën thirrje për "një normalizim të plotë dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve ... Një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në formën e një marrëveshjeje detyruesisht ligjore është çështje urgjente dhe vendimtare për perspektivën evropiane të Kosovës dhe të Serbisë..." Dokumenti tutje thekson se "deri atëherë, normalizimi i arritur gjithëpërfshirës duhet të hapë rrugën për një përparim të mëtutjeshëm e thelbësor për Kosovën në rrugëtimin e saj drejt integritimit evropian". Nëse është kështu, atëherë nuk ka perspektivë Evropiane për Kosovën pa një normalizim të plotë dhe njohje (de facto) nga Serbia; edhe nëse Kosova kishte arritur të transformojë qeverisjen e saj, institucionet, sundimin e ligjit dhe ekonominë. Për Kosovën, arritja e marrëveshjes me Serbinë duket të jetë mjeti për heqjen e barrierave për në BE.

Përderisa liderët e Kosovës dhe Serbisë parashikojnë *një grand finale*, pak kush beson se liderët serbë e kosovarë mund të arrijnë një marrëveshje që do t'i zgjidhë mosmarrëveshjet dypalëshe, dhe që do të krijojë marrëdhënie të mira fqinjësore mes dy vendeve. Në skenarin më të mirë, qeveritë mund edhe të merren vesh, por zbatimi do të merrte shumë vite dhe mund të dështojë zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Dëshmitë janë ende shumë të freskëta; historia e fundit e negociatave tregon se Beogradi dhe Prishtina mund të arrijnë marrëveshje në letër, por dështojnë në zbatimin e tyre.

Strategjia dështon në adresimin e sfidave të brendshme me të cilat ballafaqohet BE-ja në raport me Kosovën, por edhe me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Pesë shtete anëtare të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën, duke e bërë të pamundur që Komisioni të paraqesë perspektivën për aplikimin e Kosovës për statusin e shtetit kandidat për anëtarësim në BE. Strategjia vë në dukje se "MSA-ja, e cila ka hyrë në fuqi që nga viti 2016, është mjeti kyq për t'i ndihmuar Kosovës në përparimin e saj në rrugën drejt Unionit". Nuk ka si të jetë më e paqartë. Ajo nuk i referohet fare Programit të Agjendës së Reformave Evropiane. Në ndërkohë, Greqia, si shtet anëtar i BE-së, e bllokoi Maqedoninë dhe Shqipërinë. Nëse Serbia pranohet sipas kornizës së tanishme kohore, duhet të ekzistojnë dispozita për të parandaluar bllokimin e anëtarësimit të Kosovës.

Pavarësisht vështirësive dhe realitetit të hidhur, Kosova nuk ka kohë për të humbur. Ajo duhet ta shfrytëzojë mundësinë për të siguruar një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme, e cila i zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet e saj me Serbinë. Traktati duhet të përfshijë anëtarësimin e plotë në OKB dhe në organizatat tjera ndërkombëtare dhe një rrugë të qartë drejt BE-së. Po aq e rëndësishme është që qytetarët e Kosovës duhet kërkuar reforma, forcimin e institucioneve, nxitje të zhvillimit ekonomik dhe zbatimin e sundimit të ligjit. Kosova duhet të punojë shumë për përgatitjen për statusin e shtetit kandidat, ndërkohë që BE-ja duhet ta ftojë atë.

BE-ja ofron një agjendë të qartë, kërkuese por edhe sfiduese për të preferuarit e saj. Bashkimi Evropian duhet të sigurojë se kësaj radhe strategjia do të funksionojë. Institucionet në Bruksel dhe shtetet anëtare duhet të investojnë dhe dëshmojnë vullnetin e tyre politik për të ndihmuar Ballkanin Perëndimor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve bilaterale, në trajtimin dhe njohjen e të kaluarës dhe në ofrimin e ndihmës për arritjen e një pajtimi të plotë. BE-ja nuk mund të jetë më e paqartë, të ketë qasje me shumëkuptimësi ose të jetë e paanshme; BE duhet t'i kërkojë Beogradit që t'i zgjidhë (dhe zbatojë) mosmarrëveshjet dypalëshe me Prishtinën, përfshirë këtu edhe njohjen (de facto) të Kosovës.

Ftesa shteteve të Ballkanit Perëndimor për pjesëmarrje në formësimin e vendimeve në nivel të BE-së, një ftesë kjo e mirëseardhur, duhet t'i përfshijë të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6). Politikat që ndërliken me çështjet e përgjithshme, politikën e jashtme, sigurinë, mbrojtjen, energjinë, transportin ndikojnë tek të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, e jo vetëm në ato të preferuarat. Pavarësisht asaj se kush ndodhet në krye e kush në fund të listës, të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor përballen me natyrë të njejtë të problemve. Rrjedhimisht, nuk ekziston një zgjidhje e pjesshme për Ballkanin Perëndimor.

Publikimi i strategjisë së zgjerimit është një thirrje paralajmëruese për elitat dhe qytetarët e rajonit. Papritmas, BE-ja ka vendosur që ta zgjasë dorën, megjithëse vetëm pjesërisht dhe në mënyrë tejet selektive. Mirëpo, popujt e Ballkanit Perëndimor kanë një afat të përcaktuar kohor, brenda të cilit duhet të transformojnë qeverisjen, politikat ekonomike, mentalitetet dhe shoqëritë e tyre. A do të jenë të gatshëm për të bërë ndryshimin? Tani ka nevojë për veprim.

Vërejtje: Ky artikull është përpiluar në bazë të draft strategjisë së BE-së për Zgjerimin. Para publikimit të saj, më 6 shkurt 2018, sigurisht se do të ketë edhe modifikime të dokumentit zyrtar.

Ky artikull është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Civile (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA), dhe është menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij artikulli është përgjegjësi e Grupit për Kërkime të Politikave Ballkanike (BPRG) dhe ai nuk përfaqëson qëndrimin e SCO K-së, DANIDA-s apo KCSF-së.

Dhe

Ambasada e Mbretësisë së Norvegjisë.

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet e shprehura dhe analiza e këtij artikulli janë vetëm të Grupit për Ballkanin dhe ato nuk i reflektojnë pikëpamjet e donatorëve

Autor: Grupi për Kërkime të Politikave Ballkanike (BPRG)
